



RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË SISTEMEVE TË TEKNOLOGJISË
SË INFORMACIONIT NË BASHKINË ELBASAN

Titulli: “Auditimi i Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit ”

Subjekti: “Bashkia Elbasan”

Përgatitur: 07 Dhjetor 2018

Auditimi është kryer në bazë të programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 864/1, datë 11/09/2018.

Auditimi është kryer nga:

1. Kozma Kondakçiu, përgjegjës grupi
2. Meald Habazaj, anëtar
3. Aldo Kita, anëtar

Periudha e Auditimit: 01.01.2017 – 30.06.2018

Afati i auditimit: 03.09.2018 – 15.10.2018



Tiranë më 07.12.2018

PËRMBAJTJA

Nr.	EMËRTIMI	Faqe
I.	Përmbledhje	3
II.	Çfarë kemi audituar	3
III.	Pse është i rëndësishëm ky auditim	4
IV.	Gjetjet kryesore	4
V	Hyrje	9
VI	Rezultatet e auditimit	10
VI.1	Auditimi i funksionimit të Qeverisjes TIK	10
	<i>a.</i> Vlerësimi i burimeve njerëzore në strukturat TIK	10
VI.2	Auditimi i projekteve e investimeve të teknologjisë së informacionit	14
	<i>a.</i> Identifikimi, hartimi i nevojave dhe kritereve të vendosura për mallra dhe shërbime në TIK	14
	<i>b.</i> Auditimi i Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit (MNSH).	16
VI.3	Auditimi i Sigurisë së Informacionit	18
	<i>a.</i> Identifikimi dhe menaxhimi i risqeve në TIK	18
	<i>b.</i> Verifikim i shkallës së sigurisë së aplikacioneve.	20
VI.4	Të ndryshme të dala gjatë auditimit	24
VII.	Disa Konstatime dhe Rekomandime	24
VIII.	Tabela e shkurtimeve.	39

I. PËRMBLEDHJE



Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) mbështetur në nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" datë 27.11.2014, nga data 03.09.2018 deri më datë 15.10.2018 zhvilloi një Auditim të Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit në Bashkinë Elbasan bazuar në programin e auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 864/1, datë 11/09/2018. Opinionet dhe konkluzionet e nxjerra gjatë auditimit janë mbështetur në Standardet Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Auditimit, si më poshtë:

- Mandati për kryerjen e Auditimit mbështetet në ISSAI 1 Neni 22 dhe Ligjin e KLSH Nr.154/2014 Neni 3 dhe 14.
- Manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit (WGITA)¹ Gjatë këtij auditimi u përdor Manuali Aktiv i TI i cili u zhvillua gjatë it të binjakëzimit në KLSH dhe kishte objektiv thelbësor vënien në praktikë të "Manualit WGITA - IDI mbi Auditimin e TI-së për Institucionet Supreme të Auditimit".
- COBIT 4.1 Objektivat e Kontrollit të Teknologjisë së Informacionit.²
- Udhëzime mbi Auditimet Teknologjinë e Informacionit, ISSAI 5300.6, 8 dhe 12.2, 16.19, 21.1, 23.³
- ISSAI 100.36,48 Udhëzime për të gjitha auditimet e sektorit publik⁴.
- ISSAI 5310 - udhëzues për shqyrtimin e sigurisë së sistemit të informacionit (ISS) në organizatat qeveritare.

II. ÇFARË KEMI AUDITUAR

Fushat e auditimit

Auditimi i funksionimit të Qeverisjes TIK

Vlerësimi i burimeve njerëzore në strukturat TIK

Auditimi i projekteve e investimeve të teknologjisë së informacionit

Identifikimi, hartimi i nevojave dhe kriterëve të vendosura për mallra dhe shërbime në TIK

Auditimi i Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit (MNSH).

Auditimi i Sigurisë së Informacionit

Identifikimi dhe menaxhimi i risqeve në TIK

Verifikim i shkallës së sigurisë së aplikacioneve.

Të ndryshme të dala gjatë auditimit

¹ <http://www.intosaiitaudit.org/WGITA23rd/23rdWGITAMeeting/Arabic%20IT%20Audit%20Handbook.pdf>:

² http://www.klsh.org.al/web/Manual_i_Auditimit_te_Teknologjise_se_Informacionit_1488_1.php

³ http://www.klsh.org.al/web/COBIT_4_1_Objektivat_e_Kontrollit_te_Teknologjise_se_Informacionit_1555_1.php

⁴ <http://www.issai.org/data/files/75/61/65/99/F5DF8510F72E9F859B59F9C2/issai-5300-e-exposure-draft.pdf>

⁴ http://www.klsh.org.al/web/Standardet_Nderkombetare_te_Auditimit_ISSAI_1_400_1867_1.php



III. PSE ËSHTË I RËNDËSISHËM KY AUDITIM

Auditimi i Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit në Bashkinë Elbasan ka për qëllim verifikimin nëse këto sisteme përmbushin nevojat, pa kompromentuar sigurinë, privatësinë, koston dhe elemente të tjera kritike të veprimtarisë.

IV. GJETJET KRYESORE

Gjetjet kryesore, të paraqitura në këtë Raport Auditimi në mënyrë të përmbledhur sipas drejtimeve të auditimit, rezultuan si më poshtë:

Nga auditimi rezultoi se:

1. Titulli i gjetjes: Struktura IT ka një bazë rregullative të plotësuar (rregullorja e strukturës IT dhe ndarja e detyrave, rregullore për sigurinë dhe komunikimet elektronike, manuale të aplikacioneve të përfituara si rezultat i donacioneve, dokumentacion mbi procedurat e backup-it etj), por kjo bazë rregullative është e pa miratuar.

Situata: Bashkia Elbasan ka hartuar bazën rregullative të Teknologjisë së Informacionit (*rregullorja e strukturës IT dhe ndarja e detyrave, rregullore për sigurinë dhe komunikimet elektronike, manuale të aplikacioneve të përfituara si rezultat i donacioneve, dokumentacion mbi procedurat e backup*) por ky dokumentacion është i pa miratuar.

Ndikimi/efekti: Baza nënligjore e pa miratuar mbart riskun e mos detyrimit për zbatim

Shkaku: Mos përgatitja e dokumentacionit shkresor për kalim për miratim.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë Elbasan të marrin masa për miratimin e bazës rregullative të Teknologjisë së Informacionit (*rregullorja e strukturës IT dhe ndarja e detyrave, rregullore për sigurinë dhe komunikimet elektronike, manuale të aplikacioneve të përfituara si rezultat i donacioneve, dokumentacion mbi procedurat e backup*).

2. Titulli i gjetjes: Nga auditimi i procesit të identifikimit të nevojave për investime në fushën e teknologjisë së informacionit dhe priorizimit të tyre konstatohet se Strukturat e IT që marrin pjesë aktive në procesin e identifikimit të nevojave nuk përfshihen në procesin e menaxhimit të tyre si rezultat i statusit organizativ në nivel sektori nën Drejtorinë e Politikave Strategjike e Inovacionit dhe Medias.

Situata: Strukturës IT-së në Bashkinë Elbasan është në nivel sektori nën Drejtorinë e Politikave Strategjike e Inovacionit dhe Medias.

Ndikimi/efekti: Zbehje të ndikimit të IT në vendimmarrje.

Shkaku: Probleme konceptuale organizative mbi rëndësinë e IT.

Rëndësia: E lartë



Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë Elbasan të analizojnë mundësinë e ndryshimeve strukturore ekzistuese të IT me qëllim rritjen e rolit të saj dhe përfshirjen në procesin e menaxhimit të identifikimit të nevojave për investimet në fushën e teknologjisë së informacionit.

3.Titulli i gjetjes Bashkia Elbasan nuk disponon regjistër risku për Teknologjinë e Informacionit në mospërputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

3.1. Titulli i gjetjes sidhe nuk ka politika të ruajtjes së dokumenteve dhe nuk ka të dokumentuar një plan masash për identifikimin, trajtimin e gabimeve dhe incidenteve që mund të ndodhin në infrastrukturën IT. Në mungesë të procedurave të shkruara, risqet menaxhohet mbi bazë ngjarjesh.

Jepet suport, mbështetje teknike dhe logjike për operacionet IT që ndihmojnë mbarëvajtjen e strukturave të institucionit. Procedurat kryhen nëpërmjet shkëmbimeve verbale dhe nëpërmjet e-mail-eve, duke mos realizuar identifikimin e risqeve. Kjo situatë mbart riskun e përsëritjes së incidenteve. Identifikimi i risqeve çon në gjetjen e zgjidhjeve për t'i trajtuar ato dhe për të parandaluar ndodhjen e incidenteve të ngjashme në të ardhmen dhe në mënyrë që funksionet e institucionit të jenë të mbrojtura.

Situata: Mos menaxhim i incidenteve, mos vlerësim i risqeve IT, mungesa e plan veprimit për minimizimin e risqeve.

Ndikimi/efekti: Mos realizim i objektivave, shkelje të sigurisë, humbje të të dhënave.

Shkaku: Mos zbatim i ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Strukturat Drejtuese në Bashkinë Elbasan në bashkëpunim me Sektorin e Inovacionit IT dhe mbrojtjes Kibernetike të marrin masa për:

- a. identifikimin e risqeve IT dhe hartimin e regjistrit të risqeve.
- b. dokumentimin dhe monitorimin e incidenteve.
- c. menaxhimin e ndryshimeve dhe dokumentimin e tyre.

4.Titulli i gjetjes Bashkia Elbasan nuk rezulton të ketë plan të miratuar emergjence dhe politika të miratuara për vazhdimësinë e biznesit. Politika organizative mbi vazhdimësinë e ofrimit të shërbimeve duke marrë në konsideratë: rolet dhe përgjegjësitë, fushëveprimin, kërkesat për trajnim, orarin e mirëmbajtjes, orarin e testimit, nivelet e miratimit dhe palët e përfshira në këtë proces. Nuk janë përcaktuar Objektivat e Kohës së Rimëkëmbjes dhe Objektivat e Punës së Ripërtëritjes për çdo proces kritik.



Situata: Bashkia Elbasan nuk ka plan të miratuar emergjence dhe politika të vazhdimësisë së punës dhe rimëkëmbjes për proceset kritike.

Ndikimi/efekti: Mos realizim i objektivave, shkelje të sigurisë, humbje të të dhënave.

Shkaku: Mos zbatim i praktikave më të mira.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Strukturat Drejtuese në Bashkinë Elbasan në bashkëpunim Sektorin e Inovacionit IT dhe mbrojtjes Kibernetike të marrin masa për miratimin e një plani për emergjenca dhe politika mbi vazhdimësinë e biznesit.

5. Titulli i gjetjes Siguria e infrastrukturës network në Bashkinë Elbasan është e kompromentuar si rezultat i mungesës së:

- a. Active Directory dhe Domain Controller për menaxhimin e userave, pajisjeve dhe aplikacioneve dhe për një identifikim të qëndrueshëm të sigurt të kontrollit dhe menaxhimin e shërbimeve në përputhje me standardet.
- b. server të dedikuar për CA (Certificate Authority)
- c. Server i dedikuar për mail server (Exchange server)
- d. Firewall Hardware
- e. Switch të menaxhueshëm

6. Titulli i gjetjes Nga auditimi i rrjetit kompjuterik që lidh Bashkinë Elbasan me njësitë administrative rezultoi se:

- a. Përdoruesit në këto qendra janë lidhur nga fibra optike dhe marrin shërbimin në një Swich të pa menaxhueshëm.
- b. Konfigurimet në rrjet të PC janë si administratorë.
- c. Në të njëjtin swich marrin shërbime disa institucione.
- d. Nuk dokumentohet procesi i hapjes dhe mbylljes së llogarive të përdoruesve në sisteme.

Situata: Infrastrukturë pa nivel sigurie.

Ndikimi/efekti: Mos realizim i objektivave, shkelje të sigurisë, humbje të të dhënave.

Shkaku: Mungesë e investimeve

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Bashkia Elbasan për mbarëvajtjen e punës dhe për të pasur siguri në rrjet duhet të marrë masat për t'u pajisur me: Active Directory dhe Domain Controller për menaxhimin e userave, pajisjeve dhe aplikacioneve dhe për një identifikim të qëndrueshëm të sigurt të kontrollit dhe menaxhimin e shërbimeve në përputhje me standardet.; server të dedikuar për CA; Server i dedikuar për mail server, Firewall Hardware, Switch të menaxhueshëm.



7. Titulli i gjetjes Siguria e aplikacioneve si rezultat i mos dokumentimit të procesit të hapjes dhe mbylljes së kredencialeve të përdoruesve në aplikacionet është e kompromentuar.

Situata: Mos koordinim i strukturave përdoruese të sistemeve me strukturën IT.

Ndikimi/efekti: Shkelje të sigurisë, humbje të të dhënave mos realizim i objektivave

Shkaku: Mos zbatimi i rregullores së brendshme të Institucionit.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Strukturat Drejtuese në Bashkinë Elbasan në bashkëpunim me Sektorin e Inovacionit IT dhe mbrojtjes Kibernetike duhet të marrin masa për dokumentimin e procesit të hapjes dhe mbylljes së kredencialeve të përdoruesve në aplikacione.

8. Titulli i gjetjes Bashkia Elbasan nuk ka infrastrukturën e nevojshme për të siguruar aplikacionet e zhvilluara, ambienti fizik komprometon sigurinë e aplikacioneve. Bashkia Elbasan nuk ka ambient të veçantë për testime përpara kalimit të ndryshimeve në sistemin Live për aplikacionet mungesa e të cilit komprometon sigurinë e sistemit, të të dhënave si dhe vazhdimësinë e ofrimit të shërbimeve.

Situata: Infrastrukturë pa nivel sigurie.

Ndikimi/efekti: Mos realizim i objektivave, shkelje të sigurisë, humbje të të dhënave

Shkaku: Mungesë e investimeve

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Strukturat Drejtuese në Bashkinë Elbasan në bashkëpunim me Sektorin e Inovacionit IT dhe mbrojtjes Kibernetike, të marrë masa për një riorganizim të hapësirave fizike dhe logjike në pajisjet server lidhur me shërbimet që ofron aktualisht, me qëllim:

- Garantimin e vazhdimësisë së shërbimeve të ofruara.
- Përfitim të një performace më të mirë të aplikacioneve.
- Krijim hapësire për një kopje të sistemit në funksion të testimeve apo trajnimeve të ndryshme sipas rastit.

9. Titulli i gjetjes Sistemi i Administrimit të Taksave, (TAIS), nuk ndërvepron me sistemin QKB për të marrë automatikisht të dhënat e bizneseve me impakt mos informimin në kohë për bizneset e reja të regjistruara.

Situata: Baza e të dhënave të sistemit TAIS nuk ndërvepron me bazën e të dhënave të QKB, procedurat e update kryhen nga veprimet e inspektorëve në teren dhe hedhjes manualisht të informacioneve.

Ndikimi/efekti: Mos vjelje të detyrimeve.

Shkaku: Mungesë ndërveprimi mes Strukturës përgjegjëse të Bashkisë Elbasan dhe QKB-së, lidhur me mënyrën e hedhjes së bazës së të dhënave.



Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Strukturat Drejtuese në Bashkinë Elbasan, në bashkëpunim me Sektorin IT dhe Drejtorinë e Taksave Vendore të marrë masa për hartimin e një plan veprimi për të siguruar ndërveprimin e bazës së të dhënave të QKB me atë TAIS.

10. Titulli i gjetjes Sistemi i Administrimit të Taksave (TAIS) nuk disponon sisteme kontrolli për parandalimin e inpleteve të pa sakta në bazën e të dhënave, duke lejuar parregullsi në fushat e rëndësishme të bazës së të dhënave si “NIPT”, “Adresa” “Emërtimi i Biznesit” etj.

Situata: Bazë të dhënash me informacione të pa saktë për qëllimin e ndërtuar.

Ndikimi/efekti: Mos vjelje të detyrimeve. Prishje imazhi

Shkaku: Mungesa e sistemeve të kontrollit të inpleteve, mos formatimin e duhur të fushave të bazës së të dhënave.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Sektori i Inovacionit IT dhe mbrojtjes Kibernetike në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave Vendore si dhe zhvilluesin e sistemit TAIS, të marrë masa për të përcaktuar kriteret e nevojshme dhe detyrueshme të formatit për çdo fushë të bazës së të dhënave në TAIS si dhe të vendosi sisteme kontrolli për parandalimin e inpleteve të gabuara.

11. Titulli i gjetjes: Nga auditimi u konstatua se Bashkia Elbasan nuk ka Strategji për Teknologjinë e Informacionit, mungesa e të cilës sjell mos pasqyrimin e objektivave lidhur me infrastrukturën, burimet e nevojshme si dhe instrumenteve të nevojshëm për matjen e objektivave. Mungesa e Planit Strategjik, mbart riskun e keq adresimit të burimeve të nevojshme për mbështetjen e veprimtarisë së Bashkisë Elbasan.

Situata: Teknologjia e informacionit zhvillohet pa Plan Strategjik.

Ndikimi/efekti: Keq adresimi i burimeve të nevojshme për mbështetjen e veprimtarisë së Bashkisë Elbasan.

Shkaku: Mos zbatim i praktikave më të mira të fushës.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë Elbasan, duke marrë në konsideratë kohën, burimet e nevojshme si dhe rëndësinë e të dhënave që institucioni posedon dhe përpunon, të marrin masa për hartimin e Planit Strategjik të Teknologjisë së Informacionit, ku të adresohen qartë objektivat e institucionit.

12. Titulli i gjetjes Ambienti fizik i dhomës së rrjetit nuk është në përputhje me standardet e përcaktuara në Rregulloren për Ndërtimin e Dhomës së Serverëve (Versioni 1.0, datë



02.12.2008) miratuar nga AKSHI (Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit) përkatësisht:

a.Pika 4.3. Parandalimi i zjarrit.

Dhoma duhet të jetë e pajisur me një sistem të përshtatshëm kundër zjarrit

Dhoma duhet të jetë rezistent ndaj zjarrit nëse kabllot dhe sistemet e ftohjes kombinohen në të njëjtën hapësirë sipër tavanit ose nën dysheme

b.Pika 4.5. Sistemi Elektrik. Instalimi elektrik i dhomës së serverëve nuk është veçmas instalimit të përgjithshëm.

c.Pika 4.6. Sistemi i Alarmit. Mungon sistemi i alarmit. Duhet të jenë të tillë që të sinjalizojnë problemet me rrymën elektrike, me ambientin fizik, sensor për rrjedhjen e ujit, sensor për parandalimin e dëmtimeve fizike të strukturës së dhomës.

13. Titulli i gjetjes Mungon siguria fizike në dhomën e serverave dhe nuk ka sistem elektronik aksesit dhe sistem alarmi në rast hyrje të pa autorizuar.

Situata: Ambiente të pa përshtatshme për zhvillimin e infrastrukturës IT.

Ndikimi/efekti: Shkelje të sigurisë, humbje të informacionit.

Shkaku: Mos krijimi i ambientit fizik në përputhje me udhëzimet e AKSHI-t.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Bashkia Elbasan të marrë masa për ndërtimin e ambienteve të dhomave të serverave në bazë të VKM nr. 248, datë 27.04.2007 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit” dhe Rregulloren për ndërtimin e dhomës së serverëve (versioni 1.0, datë 02.12.2008) miratuar nga AKSHI, që parashikon përcaktimin e standardeve të TIK dhe praktikat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare.

V. HYRJE

Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) mbështetur në nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" datë 27.11.2014, nga data 03.09.2018 deri më datë 15.10.2018 zhvilloi një Auditim të Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit në Bashkinë Elbasan në bazë të të programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 864/1, datë 11/09/2018

Përshkrim i shkurtër i të drejtave dhe detyrave të Bashkisë Elbasan.

- Politikat bashkiake në drejtim të marrëdhënieve me publikun,
- Informimit qytetar;
- Garantimit të mbështetjes ligjore për aktet dhe aktivitetin e Bashkisë, bazuar në principet e drejtësisë, barazisë, transparencës dhe integritetit moral. Bashkia Elbasan ka mision të respektojë liritë dhe të drejtat themelore të shtetasve, nxisë pjesëmarrjen e komunitetit në qeverisje dhe vendimmarrje duke ofruar shërbime cilësore dhe lehtësira vendore në dobi të qytetarëve..



Bashkia Elbasan i kryen funksionet bazuar në:

1. Ligji 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.
2. Ligjin Nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil “(i ndryshuar).
3. Vendimi Nr. 55 dt. 08/02/2017 “Rregullore e organizimit dhe funksionimi të Bashkisë”.
4. Ligji 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” .
5. Udhëzime dhe Manuale.

Bashkia Elbasan kryen këto funksione kryesore në bazë të Ligjit Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore:

- Neni 23 Funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës.
- Neni 24 Funksionet e bashkive në fushën e shërbimeve sociale.
- Neni 25 Funksionet e bashkive në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese.
- Neni 26 Funksionet e bashkive në fushën e mbrojtjes së mjedisit.
- Neni 27 Funksionet e bashkive në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit.
- Neni 28 Funksionet e bashkive në fushën e zhvillimit ekonomik vendor.
- Neni 29 Funksionet e bashkive në fushën e sigurisë publike.

Grupi i auditimit mblodhi informacione dhe zhvilloi analiza për caktimin e zonave me risk të lartë dhe mbështetur në to, hartoi matricat e auditimit.

Kërkesat për informacion për fushat përkatëse u hartuan në përputhje me manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit. Plani i auditimit i dalë nga informacionet dhe analizat paraprake kishte për objektiv vlerësimin e sistemeve TI, dhe aspekteve që lidhen me mirëmbajtjen, zhvillimin dhe sigurinë e tyre. Mbështetur për sa më lart janë mbajtur aktet përkatëse të auditimit, janë shqyrtuar observacionet të cilat gjenden të reflektuara në këtë raport, gjithashtu kemi propozuar rekomandimet përkatëse.

VI REZULTATET E AUDITIMIT

VI.1 Auditimi i funksionimit të Qeverisjes TIK


a. Vlerësimi i burimeve njerëzore në strukturat TIK

Auditimi i burimeve njerëzore në strukturën e TIK u krye në përputhje me programin e auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 864/1, datë 11/09/2018 me objektiv vlerësimin e tyre.

Objektivi i Auditimit:

Garantimi se ekzistojnë strukturat, politikat dhe procedurat në strukturat IT që mundësojnë Bashkinë të arrijë objektivat në funksion të plotësisht të misionit.

Bashkia Elbasan shtrihet në pjesën qendrore të Shqipërisë me sipërfaqe 872 km² dhe ka 13





KONTROLI I LARTË I SHETIT

RAPORTI PËR AUDITIMIN E SISTEMEVE TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT NË BASHKINË ELBASAN

njësi administrative (Bashkia e vjetër e Elbasanit, Komuna Bradashesh, Komuna Papër, Komuna Gjergjan, Komuna Labinot-Fushë, Komuna Labinot-Mal, Komuna Funarë, Komuna Gracen, Komuna Tregan, Komuna Shushicë, Komuna Shigjan, Komuna Gjinar dhe Komuna Zavalinë).

Në zbatim të Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Kryetari i Bashkisë, nëpërmjet urdhërave dhe vendimeve, organizon dhe drejton punën e administratës për kryerjen e funksioneve të Bashkisë.


Ushtron të gjitha kompetencat në kryerjen e funksioneve të Bashkisë, me përjashtim të atyre që janë kompetencë vetëm e Këshillit Bashkiak;

Miraton strukturën organike të Bashkisë dhe miraton rregulloret e funksionimit të saj, si dhe përshkrimet e punës për pozicionet e punës në administratën e Bashkisë.

Struktura e Bashkisë Elbasan, është e miratuar me Vendimit Nr. 55, datë 08.07.2017, të Kryetarit të Bashkisë, bazuar më ligjin 139/2015 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", organizimin dhe rekrutimin e punonjësve e realizon bazuar në ligjin Nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar.

Numri i përgjithshëm i punonjësve të Bashkisë Elbasan është gjithsej 969 punonjës (pa përfshirë këtu punonjësit e institucioneve të arsimit parashkollor).

Në figurën e mëposhtme paraqitet struktura organike e Bashkisë Elbasan:






KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËR AUDITIMIN E SISTEMEVE TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT NË BASHKINË ELBASAN

Sektori i Inovacionit IT dhe mbrojtjes Kibernetike është pjesë përbërëse e Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave strategjike, Sociale, Shërbimeve Komunitare dhe Inovacionit me Objektivin administrimin e infrastrukturën, sistemet dhe shërbimet e IT-së, në shërbim dhe në funksion të mbledhjes së të ardhurave për Bashkinë Elbasan.

Aktivitetin e saj kryesor Sektori i Inovacionit IT dhe mbrojtjes Kibernetike e ka mbështetur në zbatimin e Vendimit të Kryetarit të Bashkisë Nr. 55, datë 08.02.2017.

Struktura aktuale e Sektori i Inovacionit IT dhe mbrojtjes Kibernetike është e përbërë nga 4 punonjës, një Përgjegjës Sektori, 3 Specialist të shërbimeve informatike si më poshtë:



Nr.	Sektori i Inovacionit IT dhe mbrojtjes Kibernetike	Nr. plan	Nr. Fakt
	<i>Përgjegjës Sektori</i>	1	1
1.	Specialist i shërbimeve informatike	3	3
	Totali	4	4

Struktura e burimeve njerëzore në Sektorin e Inovacionit IT dhe mbrojtjes Kibernetike është e plotësuar dhe e plotë sipas strukturës organike të përcaktuar dhe nuk ka patur lëvizje, pushime apo transferime nga puna.

I vetmi rast që evidentohet është ndërprerja e marrëdhënieve të punës të një ish Specialisti në Sektorit, i cili është larguar me kërkesën e tij.

Nga auditimi rezultoi se:

1. Titulli i gjetjes: Struktura IT ka një bazë rregullative të plotësuar (rregulloja e strukturës IT dhe ndarja e detyrave, rregullore për sigurinë dhe komunikimet elektronike, manuale të aplikacioneve të përfituara si rezultat i donacioneve, dokumentacion mbi procedurat e backup etj), por kjo bazë rregullative është e pa miratuar.

Situata: Bashkia Elbasan ka hartuar bazën rregullative të Teknologjisë së Informacionit (rregullorja e strukturës IT dhe ndarja e detyrave, rregullore për sigurinë dhe komunikimet elektronike, manuale të aplikacioneve të përfituara si rezultat i donacioneve, dokumentacion mbi procedurat e backup) por ky dokumentacion është i pa miratuar.

Ndikimi/efekti: Baza nënligjore e pa miratuar mbart riskun e mos detyrimit për zbatim

Shkaku: Mos përgatitja e dokumentacionit shkresor për kalim për miratim.

Rëndësia: E lartë



Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë Elbasan të marrin masa për miratimin e bazës rregullative të Teknologjisë së Informacionit (*rregullorja e strukturës IT dhe ndarja e detyrave, rregullore për sigurinë dhe komunikimet elektronike, manuale të aplikacioneve të përfituara si rezultat i donacioneve, dokumentacion mbi procedurat e backup*).

2. Titulli i gjetjes: Nuk ka plan trajnimi vjetor për vitet 2017-2018 për burimet njerëzore të sektorit të Teknologjisë e Informacionit. Nuk dokumentohet procesi i kërkesave, nevojave dhe analizimi i tyre. Trajnimet e përfituara nga donatorët dhe zhvilluesit e sistemeve janë të pa mjaftueshme e nuk plotësojnë nevojat për trajnim mbi sistemet, sigurinë dhe teknologjinë e informacioni për stafin IT.

Situata: Nuk ka plan trajnimi vjetor për burimet njerëzore të sektorit të Teknologjisë e Informacionit. Nga ana e burimeve njerëzore dhe Sektorit të Inovacionit IT dhe mbrojtjes Kibernetike nuk dokumentohet procesi i kërkesave, nevojave dhe analizimi i tyre. Trajnimet e përfituara nga donatorët dhe zhvilluesit e sistemeve janë të pa mjaftueshme e nuk plotësojnë nevojat për trajnim mbi sistemet, sigurinë dhe teknologjinë e informacioni për stafin IT.

Ndikimi/efekti: Mos realizimin e objektivave institucionale në fushën e IT.

Shkaku: Mos kryerja e analizës së nevojave për trajnim, mos hartimit dhe zbatimit të planit të trajnimeve nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe struktura IT

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Strukturat Drejtuese në Bashkinë Elbasan në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Sektorit të Inovacionit IT dhe mbrojtjes Kibernetike të marrin masa për identifikimin e nevojave për trajnimin e stafit IT dhe të çdo përdoruesi të sistemeve IT si dhe të hartojë e miratojë plane dhe politika për zhvillimin e trajnimeve në lidhje me sistemet, sigurinë dhe teknologjinë e informacionit.

3. Titulli i gjetjes: Organizimi i strukturës IT-së në nivel sektori nën Drejtorinë e Politikave Strategjike e Inovacionit dhe Medias, nuk i përgjigjet shtrirjes së teknologjisë së informacionit në Bashki dhe institucionet e vartësisë duke zbehur ndikimin e varësisë direkte nga menaxhimi i lartë.

Situata: Strukturës IT-së në Bashkinë Elbasan është në nivel sektori nën Drejtorinë e Politikave Strategjike e Inovacionit dhe Medias.

Ndikimi/efekti: Zbeheje të ndikimit të IT në vendimmarrje.

Shkaku: Probleme konceptuale organizative mbi rendësinë e IT

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë Elbasan të analizojnë mundësinë e ndryshimeve strukturore të strukturës ekzistuese IT me qëllim rritjen e rolit të saj.



Në lidhje me këtë pikë nga grupi i auditimit u mbajt Akt Konstatimi nr.1, datë 15.10.2018 për të cilën personat përgjegjës kanë kthyer përgjigje me nr. 5841/7, datë 25.09.2018. Në shkresë personat përgjegjës pranojnë gjetjet e auditimit Për sa më sipër grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim mbi problematikat e konstatuara.

VI.2 Auditimi i projekteve e investimeve të teknologjisë së informacionit

- Identifikimi, hartimi i nevojave dhe kriterëve të vendosura për mallra dhe shërbime në TIK
- Auditimi i Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit (MNSH).

Auditimi u krye në përputhje me programin e auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 864/1, datë 11/09/2018 me Objektiv Identifikimin, hartimin e nevojave dhe kriterëve të vendosura për mallra dhe shërbime TIK nga Bashkia Elbasan.

Bashkia Elbasan për vitin 2017 dhe periudhës nën auditim të vitit 2018 ka kryen identifikimin e nevojave në bazë strukture organizative. mbledhja e nevojave dhe kërkesave për mallra shërbime në fushën e IT (dhe jo vetëm) është kryer nga sektorët, drejtoritë, Agjencitë dhe Njësitë Administrative përbërëse të strukturës së saj.

Gjatë periudhës shtator-tetor të vitit 2016 (për vitin 2017) dhe shtator-tetor të vitit 2017 (për vitin 2018), grupet e punës së ngarkuara për hartimin e projektbuxhetit të Bashkisë kanë kryer priorizimin e nevojave në përshtatje me të ardhurat (ky proces rishikimi është kryer edhe përgjatë vitit në funksion të realizimit të planit të të ardhurave) si dhe konsolidimin e tyre sipas prioriteteve në projekt buxhetin e vitit respektiv.

Organi vendimmarrës për miratimin e planit e investimeve është Këshilli Bashkiak i cila ka kryer kryen miratimin e buxhetit (njëkohësisht edhe investimet në fushën e IT).

Struktura e IT si rezultat i statusit organizativ në nivel sektori nuk përfshihet në menaxhimin e kërkesave për përgatitjen e projekt buxhetit.

Për vitet 2017 dhe 2018 plani dhe realizimi i investimeve për fushën e IT nga Buxheti i Bashkisë Elbasan ⁵ paraqitet:

PROKURIME NË TEKNOLOGJINË E INFORMACIONIT PËR VITIN 2017						
Nr.	Parashikimi		Realizimi			
	Emërtimi	Fondi limit (lekë pa tvsh)	Data e zhvillimit	Vlera e kontratrës (lekë pa tvsh)	Data Lidhjes së	Vlefshmëria kontratës

⁵ Realizimi për vitin 2018 deri në periudhën nën auditim



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORTI PËR AUDITIMIN E SISTEMEVE TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT NË BASHKINË ELBASAN

					kontratës	
1	Kancelari	4742937	13.03.2017	3564046.73	07.07.2017	07.07.2017-31.12.2017
2.	Shërbimi i internetit për bashkinë dhe njësitë vartësë	191'805		191'775	01.08.2017	01.08.2017-31.12.2017
3.	Shërbimi i internetit për bashkinë dhe njësitë vartësë	370'833	03.07.2017	370'801	03.07.2017	03.07.2017-31.07.2017
4.	Shërbimi i internetit për bashkinë dhe njësitë vartësë	12'237'500		7'920'000	17.08.2017	17.08.2017-31.12.2019
5.	Elbasan Virtual Tour 360	1,250,000	13/11/2017	1'190'000		

PROKURIME NË TEKNOLOGJINË E INFORMACIONIT PËR VITIN 2018

Nr.	Parashikimi		Realizimi			
	Emërtimi	Fondi limit (lekë pa tvsh)	Data e zhvillimit	Vlera e kontratës (lekë pa tvsh)	Data Lidhjes së kontratës	Vlefshmëria kontratës
1	Kancelari dhe bojra	5'391'933	10.04.2018	4.164.845,91	09.08.2018	
2	Shërbimi i telefonisë fikse	416'666	22.02.2018	18 LEK PER MIN.	06.03.2018	06.03.2018-31.12.2018
3	Blerje pajisje IT	166'017	25.06.2018	164'000		
4	Riparim i kamerave te sistemit të monitorimit	666'666	25.01.2018	630'000		

1. Titulli i gjetjes: Nga auditimi i procesit të identifikimit të nevojave për investime në fushën e teknologjisë së informacionit dhe priorizimit të tyre konstatohet se Strukturat e IT



që marrin pjesë aktive në procesin e identifikimit të nevojave nuk përfshihen në procesin e menaxhimit të tyre si rezultat i statusit organizativ në nivel sektori nën Drejtorinë e Politikave Strategjike e Inovacionit dhe Medias.

Situata: Strukturës IT-së në Bashkinë Elbasan është në nivel sektori nën Drejtorinë e Politikave Strategjike e Inovacionit dhe Medias,

Ndikimi/efekti: zbehje të ndikimit të IT në vendimmarrje.

Shkaku: probleme konceptuale organizative mbi rendësin e IT

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë Elbasan të analizojnë mundësinë e ndryshimeve strukturore të strukturës ekzistuese IT me qëllim rritjen e rolit të saj dhe përfshirjen në procesin e menaxhimit të identifikimit të nevojave për investimet në fushën e teknologjisë së informacionit.

2.b. Auditimi i Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit (MNSH).

Bashkia Elbasan përgjatë periudhës 01/01/2017-30/06/2018 objekt auditimi ka realizuar 3 prokurime në fushën e IT dhe një MNSH.

Grupi i auditimit konstaton:

Për vitin 2017 2018

U kontrolluan këto Kontrata prokurimesh:

- Nr. Kontrate 8796 “Elbasan Virtual Tour 360”
- Nr. Kontrate 9756 “Projekti i monitorimit të ambientit në qytetin e Elbasanit”
- Nr. Kontrate 472 “Mirëmbajtje e platformës: Transport Inteligent”
- Nr. Kontrate 2474”Shërbim Interneti për Bashkinë Elbasan dhe njësitë e vartësisë”

2. Titulli i gjetjes: Nga auditimi i Kontratës nr. 2474 “Shërbim Interneti për Bashkinë Elbasan dhe Njësitë e vartësisë” rezultoi se grupi i marrjes në dorëzim grupi i marrjes në dorëzim nuk ka një raport të marrjen në dorëzim të punimeve të kryera (në këtë rast shërbimin e Internetit) nga OE në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, Neni 77, Pika 3. *Mbikëqyrja e kontratës.*

Në disa nga faturat Tatimore, të sjella nga Operatori Ekonomik Altelecom SH.A., Blerësi në këtë rast Autoriteti Kontraktor (Bashkia Elbasan), ka firmosur këto fatura vetëm me emrin “Bashkia Elbasan” dhe jo grupi i marrjes në dorëzim të shërbimit të internetit.

Përkatësisht në faturat nr. 90726620, nr. 90735561.

Ndërsa faturat e tjera janë firmosur vetëm nga një përfaqësues i grupit të marrjes në dorëzim.

4 MNSH

U kontrolluan këto Kontrata për MNSH (Marrëveshje Nivel Shërbimi):



- Nr. Kontrate 8796 “Elbasan Virtual Tour 360”
- Nr. Kontrate 9756 “Projekti i monitorimit të ambientit në qytetin e Elbasanit”
- Nr. Kontrate 472 “Mirëmbajtje e platformës: Transport Inteligent”

3. Titulli i gjetjes: Nga auditimi i këtyre procedurave rezultoi se të gjitha marrëveshjet e nivel shërbimit (MNSH), që janë me afat 4 vjeçar, grupi i marrjes në dorëzim nuk ka një raport për marrjen në dorëzim të punimeve të kryera nga OE në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, Neni 77, Pika 3. *Mbikëqyrja e kontratës*

Për t’u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës dhe në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara zbaton penaltitetet e parashikuara në kontratë. “Autoriteti kontraktor, gjatë kryerjes së kontrolleve mban procesverbal me shkrim në prani të kontraktorit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi” Procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i komisionit që merr në dorëzim.

4. Titulli i gjetjes: Nga auditimi i Kontratës Nr. 8796 “Elbasan Virtual Tour 360” rezultoi se, kjo kontratë nuk ka MNSH (Marrëveshje Nivel Shërbimi) në kundërshtim me pikën 3 të Udhëzimit Nr. 1159, datë 17.3.2014 për Hartimin E Marrëveshjes Së Nivelit Të Shërbimit i cili citon: *“Institucionet, të cilat janë duke zhvilluar sisteme të reja në fushën e TIK-ut, detyrimisht, të parashikojnë MNSH-në, si pjesë të procedurës së realizimit të investimit për këto sisteme. Kohëzgjatja e kësaj marrëveshjeje duhet të jetë jo më e shkurtër se 4 (katër) vjet.”*

c)U konstatua se në të gjitha MNSH nuk përfshihen: *koha e raportimit; koha e përgjigjes; prioriteti; përshkallëzimi*

Kjo në kundërshtim me pikën 7 të Udhëzimit Nr. 1159, datë 17.3.2014 për Hartimin E Marrëveshjes së Nivelit të Shërbimit e cila citon:

Të drejtat dhe detyrimet e ofruesit të shërbimit Ky seksion duhet të përcaktojë të drejtat dhe detyrimet që ofruesi i shërbimit ka ndaj institucionit, në lidhje me ofrimin e shërbimit. Për sa u përket detyrimeve, duhet të përcaktohen metodologjitë dhe specifikat e suportit të ofruesit të shërbimit të MNSH-së; për sa i përket ndërmarrjes së të gjitha veprimeve në kohën e duhur. Në lidhje me shërbimet që do të përcaktohen në marrëveshje, ofruesi i shërbimeve duhet t’u përgjigjet dhe të zgjidhë kërkesat ose incidentet e paraqitura nga institucioni. Gjithashtu, ofruesi i shërbimit duhet të ofrojë dokumentacionin e plotë për komponentët e shërbimit; të garantojë personel të kualifikuar dhe në numër të mjaftueshëm për realizimin e shërbimit; të ofrojë sigurimin e pjesëve të këmbimit (kur është e aplikueshme) dhe në sasinë që do të duhen për t’u ndërruar brenda harqeve kohore të përcaktuara.

Situata: Hartimi dhe zbatimi i procedurave të prokurimit.

Ndikimi/efekti: rrisht në mos zbatimin e procedurave në përputhje me legjislacionin në fuqi.



Shkaku: Mos hartim në përputhje me DST i kontratave, mos zhvillimi i kualifikimit të stafit me legjislacionin mbi procedurat e prokurimit publik.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Strukturat Drejtuese në Bashkinë Elbasan në të ardhmen për të shmangur mangësi në praktikat e zbatimit të kontratave duhet të marrin masa për zbatimin në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në lidhje me këtë pikë nga grupi i auditimit u mbajt Akt Konstatimi nr. 5, datë 15.10.2018 për të cilën personat përgjegjës kanë kthyer përgjigje me nr. 5841/7, datë 25.09.2018. Në shkresë personat përgjegjës pranojnë gjetjet e auditimit Për sa më sipër grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim mbi problematikat e konstatuara.


VI.3 Auditimi i Sigurisë së Informacionit

Auditimi u krye **në përputhje me programin e auditimit** të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 864/1, datë 11/09/2018 me *Objektiv* Identifikimin se si Bashkia Elbasan menaxhon risqet në TIK dhe siguron shkallën e duhur të sigurisë së aplikacioneve.

- a. Identifikimi dhe menaxhimi i risqeve në TIK
- b. Verifikim i shkallës së sigurisë së aplikacioneve.

3.a Identifikimi dhe menaxhimi i risqeve në TIK

Menaxhimi i riskut IT është aplikimi i metodave të menaxhimit të rrezikut në teknologjinë e informacionit për të menaxhuar rrezikun e TI-së, pra: Rreziku i biznesit që lidhet me përdorimin, pronësinë, operimin, përfshirjen, ndikimin dhe adoptimin e IT në Bashkinë Elbasan.



Struktura e network Bashkia Elbasan

Gjetje nga Auditimi :

1. Titulli i gjetjes Bashkia Elbasan nuk disponon regjistër rrishtu për teknologjinë e informacionit në mospërputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin



financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

2. Titulli i gjetjes Bashkia Elbasan nuk ka politika të ruajtjes së dokumenteve dhe nuk ka të dokumentuar një plan masash për identifikimin, trajtimin e gabimeve dhe incidenteve që mund të ndodhin në infrastrukturën IT, në mungesë të procedurave të shkruara, risqet menaxhohet mbi bazë ngjarjesh.

Jepet suport, mbështetje teknike dhe logjike për operacionet IT që ndihmojnë mbarëvajtjen e strukturave të institucionit. Procedurat kryhen nëpërmjet shkëmbimeve verbale dhe nëpërmjet e-mail-eve, duke mos realizuar identifikimin e risqeve, mbart riskun e përsëritjes së incidenteve. Identifikimi i risqeve çon në gjetjen e zgjidhjeve për t'i trajtuar ato dhe për të parandaluar ndodhjen e incidenteve të ngjashme në të ardhmen dhe në mënyrë që funksionet e institucionit të jenë të mbrojtura.

Situata: Mos menaxhim i incidenteve, mos vlerësim i risqeve IT, mungesa e plan veprimit për minimizimin e risqeve.

Ndikimi/efekti: Mos realizim i objektivave, shkelje të sigurisë, humbje të të dhënave.

3. Shkaku: Mos zbatim i ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Strukturat Drejtuese në Bashkinë Elbasan në bashkëpunim me Sektorit të Inovacionit IT dhe mbrojtjes Kibernetike të marrin masa për:

- d. identifikimin e risqeve IT dhe hartimin e regjistrit të risqeve.
- e. dokumentimin dhe monitorimin e incidenteve.
- f. menaxhimin e ndryshimeve dhe dokumentimin e tyre.

4. Titulli i gjetjes Bashkia Elbasan nuk rezulton të ketë plan të miratuar emergjence dhe politika të miratuara për vazhdimësinë e biznesit. Politika organizative mbi vazhdimësinë e ofrimit të shërbimeve duke marrë në konsideratë: rolet dhe përgjegjësitë, fushëveprimin, kërkesat për trajnim, orarin e mirëmbajtjes, orarin e testimit, nivelet e miratimit dhe palët e përfshira në këtë proces. Nuk janë përcaktuar Objektivat e Kohës së Rimëkëmbjes dhe Objektivat e Punës së Ripërtëritjes për çdo proces kritik.

Situata: Bashkia Elbasan nuk ka plan të miratuar emergjence dhe politika të vazhdimësisë së punës dhe rimëkëmbjes për proceset kritike.

Ndikimi/efekti: Mos realizim i objektivave, shkelje të sigurisë, humbje të të dhënave

Shkaku: Mos zbatim i praktikave më të mira.

Rëndësia: E lartë



Rekomandimi: Strukturat Drejtuese në Bashkinë Elbasan në bashkëpunim Sektorin e Inovacionit IT dhe mbrojtjes Kibernetike të marrin masa për miratimin e një plani për emergjenca dhe politika mbi vazhdimësinë e biznesit.

5. **Titulli i gjetjes** Siguria e infrastrukturës network në Bashkinë Elbasan është e kompromentuar si rezultat i mungesës së:

f. Active Directory dhe Domain Controller për menaxhimin e userave, pajisjeve dhe aplikacioneve dhe për një identifikim të qendëruar të sigurt të kontrollit dhe menaxhimin e shërbimeve në përputhje me standardet.

g. server të dedikuar për CA (Certificate Authority)

h. Server i dedikuar për mail server (Exchange server)

i. Firewall Hardware

j. Switch të menaxhueshëm

6. **Titulli i gjetjes** Nga auditimi i rrjetit kompjuterik që lidh Bashkinë Elbasan me qendrat administrative rezultoi se:

e. Përdoruesit në këto qendra janë lidhur nga fibra optike dhe marrin shërbimin në një Swich të pa menaxhueshëm.

f. Konfigurimet në rrjet të PC janë si administratorë.

g. Në të njëjtin swich marrin shërbime disa institucione.

7. **Titulli i gjetjes** Nuk dokumentohet procesi i hapjes dhe mbylljes së përdoruesve në sisteme.

Situata: Infrastrukturë pa nivel sigurie.

Ndikimi/efekti: Mos realizim i objektivave, shkelje të sigurisë, humbje të të dhënave

Shkaku: Mungesë e investimeve

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Bashkia Elbasan për mbarëvajtjen e punës dhe për të pasur siguri në rrjet duhet të marri masat për t'u pajisur me: Active Directory dhe Domain Controller për menaxhimin e userave, pajisjeve dhe aplikacioneve dhe për një identifikim të qendëruar të sigurt të kontrollit dhe menaxhimin e shërbimeve në përputhje me standardet.; server të dedikuar për CA; Server i dedikuar për mail server, Firewall Hardware, Switch të menaxhueshëm

Në lidhje me këtë pikë nga grupi i auditimit u mbajt Akt Konstatimi nr. 3 , datë 15.10.2018 për të cilën personat përgjegjës kanë kthyer përgjigje me nr. 5841/7, datë 25.09.2018. Në shkresë personat përgjegjës pranojnë gjetjet e auditimit Për sa më sipër grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim mbi problematikat e konstatuara.



3.b . Verifikimi i shkallës së sigurisë së aplikacioneve

Vlerësimi nëse informacioni i aplikacionit është i sigurt kundrejt keqpërdorimeve.

Bashkia Elbasan si rezultat i investimeve të kryera nga donatorët (USAID) ka zhvilluar dhe është në proces të implementimit të aplikacioneve si më poshtë:

Sistemit i Administrimit të Taksave (TAIS)

Implementimi i sistemit të administrimit të taksave (TAIS Tax Administration Information System, në proces zhvillimi nga USAID) është një sistem i ndërtuar mbi Microsoft Dynamic NAV dhe është një sistem i administrimit të taksave lokale të Bashkisë Elbasan. Ky sistem bën të mundur regjistrimin e të gjithë taksapaguesve në qytetin e Elbasanit, gjenerimin e detyrimeve për çdo taksapagues, llogaritjen e kamat vonesave, ndryshimet e domosdoshme për bizneset etj. Serveri i TAIS është në godinën qendrore të Bashkisë ndërsa zyrat e taksave janë të lidhur me fiber optike me godinën qendrore.

Lidhja e përdoruesve me sistemin e-taksave bëhet nëpërmjet firewall.

Sistem i Administrimit të Financave (FAIS)

Implementimi i sistemit të administrimit të financave vendore (TAIS Financial Administration Information System) është një sistem i administrimit të financave lokale të Bashkisë Elbasan i ndërtuar mbi Microsoft Dynamic NAV. Ky sistem (në proces zhvillimi nga USAID) do të bëjë të mundur çeljen e vitit financiar duke bërë regjistrimet e furnitorëve, detyrimeve, regjistrimet e të gjithë artikujve, regjistrimet e likuidimeve etj.

Monitorimi i ambientit në qytetin e Elbasanit

Ky sistem bën matjen e cilësisë së ajrit si një projekt pilot në rrugën drejt përmbushjes së Standardeve të cilësisë sipas Strategjisë Kombëtare të Mjedisit dhe standardeve të Shqipërisë dhe Bashkimit Europian.

Ky sistem me anë të stacioneve bazë të vendosura në qytet bën matjen dhe dërgimin e të dhënave në stacionin qendror të këtyre parametrave:

Monoxide Carbon (CO)	Dioxide Sulfuri (SO ₂)
Dioxide Carbon (CO ₂)	Amoniak (NH ₃)
Ozone (O ₃)	Hydrogen Sulfide (H ₂ S)
Dioxide Nitric (NO ₂)	Grimcat e pluhurit (PM ₁ /PM _{2.5} / PM ₁₀)
Temperature	Zhurma

Transporti Inteligjent

Ky aplikacion është ndërtuar për përmirësimin e cilësisë dhe efektivitetit të shërbimit të transportit në qytetin e Elbasanit, me qëllim që të bëjmë transportin publik më të parashikueshëm, me kosto efektive dhe tërheqës me anë të mjeteve informuese për oraret, planifikim të linjave dhe të një informacioni më efektiv duke shfaqur në kohë reale kohën dhe distancën e autobuzave të linjave. Me anë të aplikacionit mobile gjithkush mund të



informohet për linjat e autobuzave në qytetin e Elbasanit, stacionet më të afërta, vendodhjen e autobuzave në kohë reale, të gjitha stacionet, oraret si dhe lajmërimet apo njoftime të ndryshme.

Ambienti ku zhvillohen këto aplikacione

Bashkia Elbasan ka një dhomë të dedikuar për serverët e saj dhe për rrjetin LAN ku janë instaluar 12 Servera të cilët plotësojnë nevojat për WEB, Aplikacionin Software si dhe shërbimet e ofruara nëpërmjet Web-Service.

- 1- Hp DL380 Serveri TAIS/FAIS
- 2- Dell RS510
- 3- Dell MD3200i Storage
- 4- Dell PWE 430 Serveri Monitorimit te Ajrit
- 5- HP DL380 G4
- 6- HP DL380 G4 Firewall Ipfire (Test)
- 7- Dell PWE 840
- 8- HP DL120 G9 Star 1
- 9- HP DL380 G4 Elastix Server
- 10- 3 Serverat e Transportit Inteligent.

Nga Auditimi u konstatua se:

1. **Titulli i gjetjes** Siguria e aplikacioneve si rezultat i mos dokumentimit të procesit të hapjes dhe mbylljes së kredencialeve të përdoruesve në aplikacionet është e kompromentuar.

Situata: Mos koordinim i strukturave përdoruese të sistemeve me strukturën IT.

Ndikimi/efekti: Shkelje të sigurisë, humbje të të dhënave mos realizim i objektivave

Shkaku: Mos zbatim e rregullores së brendshme.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Strukturat Drejtuese në Bashkinë Elbasan në bashkëpunim me Sektorin e Inovacionit IT dhe mbrojtjes Kibernetike duhet të marrin masa për dokumentimin e procesit të hapjes dhe mbylljes së kredencialeve të përdoruesve në aplikacione.

2. **Titulli i gjetjes** Bashkia Elbasan nuk ka infrastrukturën e nevojshme për të siguruar aplikacionet e zhvilluara, ambienti fizik komprometon sigurinë e aplikacioneve. Bashkia Elbasan nuk ka ambient të veçantë për testime përpara kalimit të ndryshimeve në sistemin Live për aplikacionet mungesa e të cilit komprometon sigurinë e sistemit, të dhënave si dhe vazhdimësinë e ofrimit të shërbimeve.

Situata: Infrastrukturë pa nivel sigurie.

Ndikimi/efekti: Mos realizim i objektivave, shkelje të sigurisë, humbje të të dhënave



Shkaku: Mungesë e investimeve

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Strukturat Drejtuese në Bashkinë Elbasan në bashkëpunim me Sektorin e Inovacionit IT dhe mbrojtjes Kibernetike, të marrë masa për një riorganizim të hapësirave fizike dhe logjike në pajisjet server lidhur me shërbimet që ofron aktualisht, me qëllim:

- Garantimin e vazhdimësisë së shërbimeve të ofruara
- Përfitim të një performancë më të mirë të aplikacioneve
- Krijim hapësirë për një kopje të sistemit në funksion të testeve apo trajnimeve të ndryshme sipas rastit.

3. Titulli i gjetjes Sistemi i Administrimit të Taksave (TAIS) nuk ndërvepron me sistemin QKB për të marrë automatikisht të dhënat e bizneseve me impakt mos informimin në kohë për bizneset e reja të regjistruara.

Situata: Baza e të dhënave të sistemit TAIS nuk ndërvepron me bazën e të dhënave të QKB procedurat e update kryhen nga veprimet e inspektorëve në teren dhe hedhjes manualisht të informacioneve.

Ndikimi/efekti: Mos vjelje të detyrimeve.

Shkaku: Mos ndërveprim i bazave të të dhënave.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Strukturat Drejtuese në Bashkinë Elbasan, në bashkëpunim me Sektorin IT dhe Drejtorinë e Taksave Vendore të marrë masa për hartimin e një plan veprimi për të siguruar ndërveprimin e bazës së të dhënave të QKB me atë TAIS.

4. Titulli i gjetjes Sistemi i Administrimit të Taksave (TAIS) nuk disponon sisteme kontrolli për parandalimin e inputeve të pa sakta në bazën e të dhënave, duke lejuar parregullsi në fushat e rëndësishme të bazës së të dhënave si “NIPT”, “Adresa” “Emërtimi i Biznesit”

Situata: Bazë të dhënash me informacione të pa saktë për qëllimin e ndërtuar.

Ndikimi/efekti: Mos vjelje të detyrimeve. Prishje imazhi

Shkaku: Mungesa e sistemeve të kontrollit të inputeve, mos formatimin e duhur të fushave të bazës së të dhënave.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Sektori i Inovacionit IT dhe mbrojtjes Kibernetike në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave Vendore si dhe zhvilluesin e sistemit TAIS, të marrë masa për të përcaktuar kriteret e nevojshme dhe detyrueshme të formatit për çdo fushë të bazës së të dhënave në TAIS si dhe të vendosi sisteme kontrolli për parandalimin e inputeve të gabuara.



4. **Titulli i gjetjes** Siguria e vazhdimësisë së punës së aplikacioneve është e cenuar nga:

- a. Mungesa e testeve të Back-up dhe Resotre
- b. Mos përcaktimin në rregullore të frekuencës së kryerjes së Back-up dhe testimit të tij
- c. Mos përcaktimi i afatit të ruajtjes së informacionit në Backup
- d. Ruajtjes të Back-up në të njëjtin ambient me bazën e të dhënave primare (dhoma e serverave).

Situata: Mungesa e rregullave për Back-up dhe Restore.

Ndikimi/efekti: Humbje e të dhënave

Shkaku: Mos zbatim i procedurave, mungesa e infrastrukturës së nevojshme.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Strukturat Drejtuese në Bashkinë Elbasan në bashkëpunim me Sektorin e Inovacionit IT dhe mbrojtjes Kibernetike, të marrë masa për përcaktimin e kryerjes së testeve të Back-Up dhe Restore, frekuencën e kryerjes së këtyre testeve, afatin e ruajtjes së informacionit në Back-Up si dhe ruajtja e Back Up në një ambient të ndryshëm nga ai i dhomës së serverave.

Në lidhje me këtë pikë nga grupi i auditimit u mbajt Akt Konstatimi nr. 6 , datë 15.10.2018 për të cilën personat përgjegjës kanë kthyer përgjigje me nr. 5841/7, datë 25.09.2018. Në shkresë personat përgjegjës pranojnë gjetjet e auditimit Për sa më sipër grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim mbi problematikat e konstatuara.

VI.4 Të ndryshme të dala gjatë auditimit

a. Verifikimi i Strategjisë, politikave dhe procedurave TIK

Auditimi u krye me objektiv konfirmimin nëse ekziston një strategji IT, e cila përfshin plan IT dhe proceset për zhvillimin, aprovimin, dhe zbatimin dhe mirëmbajtjen e strategjisë, e cila është e lidhur me strategjinë dhe objektivat e Bashkisë. Risqet dhe burimet gjatë përmbushjes së objektivave të IT janë të menaxhuara efektivisht.

Bashkisë Elbasan është institucion buxhetor, që e zhvillon aktivitetin e saj në territorin e qytetit të Elbasanit. Struktura organizative, emërtimet dhe numri i personelit të Bashkisë miratohet nga Këshilli Bashkiak, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

Vizioni i Bashkisë Elbasan është të ofrojë një sistem të ndershmë të administrimit të taksave vendore, të arritshëm dhe që t'ju përgjigjet taksapaguesve.

Qëllimet strategjike të Bashkisë Elbasan përfshijnë:

- ofrimin e shërbimeve me cilësi dhe në kohë për taksapaguesit, nëpërmjet menaxhimit të sistemeve të regjistrimit,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËR AUDITIMIN E SISTEMEVE TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT NË BASHKINË ELBASAN

- dhënien e informacionit, shpjegimit, llogaritjes së detyrimit/ve;
- përsheptim dhe lehtësim të procedurave për pagesat e taksave vendore për të gjitha subjektet taksapaguese që ushtrojnë aktivitetin e tyre në qytetin e Elbasanit.

Një ndër detyra kryesore të Bashkisë Elbasan është vjelja e taksave dhe tarifave me qëllim shmangien e evazionit fiskal dhe uljen e numrit të subjekteve debitorë, nëpërmjet zbatimit të ligjit dhe ndërtimit të marrëdhënieve me taksapaguesit.

Veprimtaria e Bashkisë Elbasan për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore mbështetet në bazën ligjore si më poshtë:

- Ligjin Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”;
- Ligjin Nr. 9920, datë 26.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”;
- Vendimin Nr. 55 datë 08.02.2017 të Kryetarit të Bashkisë “Për miratimin e Rregullores së Funksionimit të Bashkisë”;
- Të gjitha aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi sikundër dhe vendimet e Këshillit Bashkiak për këtë qëllim.

Një vend të rëndësishëm në objektivat vjetore të Bashkinë Elbasan, është implementimi i infrastrukturës së përshtatshme IT për ofrimin e shërbimeve të planifikuara për të gjithë taksapaguesit, qytetarët si dhe specialistët e Bashkinë Elbasan.

Sistemi Informatik për Menaxhimin e Taksave Vendore që Bashkia Elbasan administron, nisur edhe nga vetë emërtimi dhe qëllimi i këtij sistemi, zhvillimi dhe implementimi i tij lidhet ngushtë me objektivat dhe dhënien e shërbimit të synuar nga Bashkia Elbasan.

Nga Auditimi u konstatua se:

1.Titulli i gjetjes: Nga auditimi u konstatua se Bashkia Elbasan nuk ka Strategji për Teknologjinë e Informacionit, mungesa e të cilës sjell mos pasqyrimin e objektivave lidhur me infrastrukturën, burimet e nevojshme si dhe instrumenteve të nevojshëm për matjen e objektivave. Mungesa e Planit Strategjik, mbart riskun e keq adresimit të burimeve të nevojshme për mbështetjen e veprimtarisë së Bashkisë Elbasan.

Situata: Teknologjia e informacionit zhvillohet pa Plan Strategjik.

Ndikimi/efekti: Keq adresimit të burimeve të nevojshme për mbështetjen e veprimtarisë së Bashkisë Elbasan

Shkaku: Mos zbatim i praktikave më të mira të fushës.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë Elbasan, duke marrë në konsideratë kohën, burimet e nevojshme si dhe rëndësinë e të dhënave që institucioni posedon dhe përpunon, të marrin masa për hartimin e Planit Strategjik të Teknologjisë së Informacionit, ku të adresohen qartë objektivat e institucionit.



2. Titulli i gjetjes Standardet e Praktikave me të mira të rekomandojnë që Qeverisja TIK duhet të vendosi politika në fushën e IT. Këto politika vendosin kërkesat për mbrojtjen e aseteve të informacionit dhe mund ti referohen procedurave ose mjeteve të tjera në mënyrën sesi këto do të mbrohen. Politikave duhet të jenë të disponueshme ndaj të gjithë punonjësve përdorues të IT. Bashkia Elbasan nuk ka vendosur politika e parime mbi sigurinë dhe Vazhdueshmërisë së Punës së Institucionit. Bashkia Elbasan nuk ka krijuar facilitetet e nevojshme për vënien në dispozicion rregulloreve dhe politikave të gjithë punonjësve përgjegjës mbi sigurinë e informacionit, përfshirë përdoruesit e sistemeve të cilët kanë rol në mbrojtjen e informacionit me qëllim që të gjithë punonjësit të familjarizohen dhe ta bëjnë pjesë të mënyrës së të menduarit dhe të veprimtarisë së tyre të përditshme.

Situata: Nuk janë krijuar facilitetet e nevojshme për vënien në dispozicion të rregulloreve dhe politikave të gjithë punonjësve përgjegjës mbi sigurinë e informacionit, përfshirë përdoruesit e sistemeve të cilët kanë rol në mbrojtjen e informacionit

Ndikimi/efekti: Mos realizim të objektivave, shkelje të sigurisë, humbje të të dhënave.

Shkaku: Mos përdorimi i mjeteve të komunikimit si intranet etj.

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë Elbasan, të marrin masa për familjarizimin me rregulloret dhe politikave TIK për të gjithë punonjësve përgjegjës mbi sigurinë e informacionit, përfshirë përdoruesit e sistemeve të cilët kanë rol në mbrojtjen e informacionit.

3. Titulli i gjetjes *Rregullorja e Brendshme, lidhur me strukturën IT në Bashkinë Elbasan*, nuk është në përputhje me rekomandimet e AKSHIT, rregullorja nuk përmban elementët e nevojshëm për të siguruar funksionim e përshtatshëm të strukturës IT në institucion.

Situata: Mos hartimi i rregulloreve në përputhje me udhëzimet e AKSHI-t dhe praktikave më të mira.

Ndikimi/efekti: Mos shfrytëzim i kapaciteteve të Burimeve Njerëzore, mos mbulim me procedura të proceseve IT.

Shkaku: Mos zbatim i praktikave e udhëzimeve të fushës.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Bashkia Elbasan të hartojë, dhe miratojë *Rregullorja e Brendshme, lidhur me strukturën IT*. Hartimi i kësaj Rregulloreje të marrë në konsideratë vendosjen e kontrolleve të brendshme lidhur me menaxhimin e riskut, përputhshmërinë me procedurat dhe rregullat e brendshme aktuale të sektorit si dhe me legjislacionin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Shqipëri.



Në lidhje me këtë pikë nga grupi i auditimit u mbajt Akt Konstatimi nr. 2 , datë 15.10.2018 për të cilën personat përgjegjës kanë kthyer përgjigje me nr. 5841/7, datë 25.09.2018. Në shkresë personat përgjegjës pranojnë gjetjet e auditimit Për sa më sipër grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim mbi problematikat e konstatuara.


b.1. Verifikimi i shkallës së sigurisë fizike dhe aksesit në rrjet

Parandalimin e vjedhjes ose të dëmtimit të pajisjeve kompjuterike, aksesit të paautorizuar, kopjimit ose shikimit të informacionit sensitiv.

Ambienti fizik i dhomave të serverëve.

Dhoma e serverave është vendi fizik ku ruhen dhe qëndrojnë kryesisht serverat dhe pajisje të tjera ndihmëse që nevojiten për shërbimet e komunikimit, sinjalizimit dhe pajisje të tjera elektronike. Dhoma e serverave është pika më sensibël e një sistemi informatikë dhe përqendrimi i pajisjeve kompjuterike, mekanike, elektrike dhe elektronike është më i lartë se në ambientet e tjera të punës. Dëmet eventuale të shkaktuara në këtë ambient do sillnin probleme serioze në funksionimin e të gjithë sistemit.

Ambientet e dhomës së serverave të Bashkisë Elbasan



- *Fotografia 1 dhe 2: Paraqesin dy Rack-e me struktura fizike metalike dhe pjesët përbërëse të sistemit të pajisjeve elektronike dhe elektrike: server, switch, router, UPS, panele etj*
- *Fotografia 3: Paraqet sistemin e ftohjes së dhomës së serverave.*



Nga Auditimi u konstatua se:

1. Titulli i gjetjes Ambienti fizik i dhomës së rrjetit nuk është në përputhje me standardet e përcaktuara në Rregulloren për Ndërtimin e Dhomës së Serverëve (Versioni 1.0, datë 02.12.2008) miratuar nga AKSHI (Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit) përkatësisht:

d.Pika 4.3. Parandalimi i zjarrit.

Dhoma duhet të jetë e pajisur me një sistem të përshtatshëm kundër zjarrit

Dhoma duhet të jetë rezistente ndaj zjarrit nëse kabllot dhe sistemet e ftohjes kombinohen në të njëjtën hapësirë sipër tavanit ose nën dysheme

e.Pika 4.5. Sistemi Elektrik. Instalimi elektrik i dhomës së serverëve nuk është veçmas instalimit të përgjithshëm.

f. Pika 4.6. Sistemi i Alarmit. Mungon sistemi i alarmit. Duhet të jenë të tillë që të sinjalizojnë problemet me rrymën elektrike, me ambientin fizik, sensor për rrjedhjen e ujit, sensor për parandalimin e dëmtimeve fizike të strukturës së dhomës.

2.Titulli i gjetjes Mungon siguria fizike në dhomën e serverave dhe nuk ka sistem elektronik aksesit dhe sistem alarmi në rast hyrje të pa autorizuar.

Situata: Ambiente të pa përshtatshme për zhvillimin e infrastrukturës IT.

Ndikimi/efekti: Shkelje të sigurisë, humbje të informacionit.

Shkaku: Mos krijimi i ambientit fizik në përputhje me udhëzimet e AKSHI-t.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Bashkia Elbasan të marr masa për ndërtimin e ambienteve të dhomave të serverave në bazë të VKM nr. 248, datë 27.04.2007 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit” dhe Rregulloren për ndërtimin e dhomës së serverëve (versioni 1.0, datë 02.12.2008) miratuar nga AKSHI, që parashikon përcaktimin e standardeve të TIK dhe praktikat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare.

Testimi i Web të Bashkisë Elbasan për dobësi .

Për testimin e performancës së faqes së internetit të Bashkisë Elbasan <http://www.elbasani.gov.al> u krye një testim i sigurisë dhe mangësive.

3. Titulli i gjetjes Komunikimi ndërmjet Web Browser-it dhe serverit kryhet duke përdorur protokollin HTTP, i cili i merr dhe jep informacion në mënyrë jo të sigurt në rrjet. Kjo sjell që, një sulmues i jashtëm, i cili arrin të hyj në rrjeti, ka mundësi të lexojë dhe ndryshojë informacionin i cili aksesoret nga rrjeti, duke përfshirë (fjalëkalimet-et, të dhëna sekret si dhe të tjera të dhëna sensitive).



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËR AUDITIMIN E SISTEMEVE TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT NË BASHKINË ELBASAN

Nëse ndodh një sulm, tipit të software-ve dhe versioni i përdorur identifikohen lehtësisht dhe mund të përdoren për sulme specifike.

Mbrojtësi X-XSS i HTTP dikton shfletuesin (browserin) të mos hap faqe webi të cilat kapin sulme Cross-Site Scripting (XSS) të reflektuar. Për shkak të këtij mbrojtësi, web siti ekspozohen përdoruesit tek sulmuesit e XSS, nëse faqia web i ka këto dobësi.

Situata: Komunikim pa norma sigurie.

Ndikimi/efekti: Humbje informacioni, prishje të imazhit.

Shkaku: Mos përdorim të rekomandimeve për sigurinë e faqeve web.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Bashkia Elbasan të marri masat për të rikonfiguruar Web Server të përdor protokollin HTTPS, i cili kodon komunikimin ndërmjet Web Browserit dhe Serverit

Në lidhje me këtë pikë nga grupi i auditimit u mbajt Akt Konstatimi nr. 4 , datë 15.10.2018 për të cilën personat përgjegjës kanë kthyer përgjigje me nr. 5841/7, datë 25.09.2018. Në shkresë personat përgjegjës pranojnë gjetjet e auditimit Për sa më sipër grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim mbi problematikat e konstatuara.

VII. DISA KONSTATIME DHE REKOMANDIME

A. OPINION I AUDITIMIT:

Grupi i auditimit KLSH duke vlerësuar rolin e teknologjisë së informacionit në përmbushjen e misionit të Bashkisë Elbasan, duke mbështetur auditimin në Standardet Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI 1 Neni 22, Ligjin e KLSH Nr.154/2014 Neni 3 dhe 14, Manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit (WGITA), COBIT 4.1, ISSAI 5300.6, 8 dhe 12.2, 16.19, 21.1, 23, ISSAI 100.36,48, ISSAI 5310), pas shqyrtimit të të dhënave dhe dokumentacionit TI të vënë në dispozicion nga Bashkia Elbasan, arriti në konkluzionin se:

Bashkia Elbasan ka zhvilluar sisteme të Teknologjisë së Informacionit në funksion të përmbushjes së objektivave të institucionit duke shfrytëzuar burimet e vena në dispozicion si dhe kryer thithjen e investimeve të konsiderueshme nga donatorët e huaj për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturën TI. Investimet në sistemet e informacionit nuk kanë zgjidhur përfundimisht problemet e sigurisë së informacionit, sigurimin e Vazhdueshmërisë së Biznesit dhe nuk kanë siguruar Rimëkëmbjen nga Katastrofat. Zhvillimi i shërbimeve dhe infrastrukturës duhet të mbështetet në praktikën më të mira si dhe rekomandimet e AKSHIT.

Rezultatet e arritura janë të kompromentuar nga mungesa e Strategjisë për Teknologjinë e Informacionit, duke mbartur riskun e keq adresimit të burimeve të nevojshme për mbështetjen e veprimtarisë së Bashkisë Elbasan.



B. MASA ORGANIZATIVE:

1. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi u konstatua se Struktura IT ka një bazë rregullative të plotësuar (rregullorja e strukturës IT dhe ndarja e detyrave, rregullore për sigurinë dhe komunikimet elektronike, manuale të aplikacioneve të përfituara si rezultat i donacioneve, dokumentacion mbi procedurat e backup etj...), por kjo bazë rregullative është e pa miratuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën VI.1, faqet nr. 10-13. të raportit të Auditimit.)

1.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë Elbasan të marrin masa për miratimin e bazës rregullative të Teknologjisë së Informacionit (rregullorja e strukturës IT dhe ndarja e detyrave, rregullore për sigurinë dhe komunikimet elektronike, manuale të aplikacioneve të përfituara si rezultat i donacioneve, dokumentacion mbi procedurat e backup).

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi u konstatua se nuk ka plan trajnimi vjetor për vitet 2017-2018 për burimet njerëzore të sektorit të Teknologjisë e Informacionit. Nuk dokumentohet procesi i kërkesave, nevojave dhe analizimi i tyre. Trajnimet e përfituara nga donatorët dhe zhvilluesit e sistemeve janë të pa mjaftueshme e nuk plotësojnë nevojat për trajnim mbi sistemet, sigurinë dhe teknologjinë e informacioni për stafin IT.

(Më hollësisht trajtuar në pikën VI.1, faqen nr. 13. të raportit të Auditimit.)

2.1 Rekomandimi: Strukturat Drejtuese në Bashkinë Elbasan në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Sektorin e Inovacionit IT dhe mbrojtjes Kibernetike të marrin masa për identifikimin e nevojave për trajnimin e stafit IT dhe të çdo përdoruesi të sistemeve IT si dhe të hartojë e miratojë plane dhe politika për zhvillimin e trajnimeve në lidhje me sistemet, sigurinë dhe teknologjinë e informacionit.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2019 dhe në vijimësi

3. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi u konstatua se Organizimi i Strukturës IT në nivel sektori nën Drejtorinë e Politikave Strategjike e Inovacionit dhe Medias, nuk i përgjigjet shtrirjes së teknologjisë së informacionit në Bashkinë Elbasan dhe institucionet e vartësisë duke zbehur ndikimin e varësisë direkt nga menaxhimi i lartë. Nga auditimi i procesit të identifikimit të nevojave për investime në fushën e teknologjisë së informacionit dhe priorizimit të tyre konstatohet se Strukturat e IT që marrin pjesë aktive në procesin e identifikimit të nevojave nuk përfshihen në procesin e menaxhimit të tyre si rezultat i statusit organizativ në nivel sektori nën Drejtorinë e Politikave Strategjike e Inovacionit dhe Medias. (Më hollësisht trajtuar në pikën VI, faqet nr. 13-14 të raportit të Auditimit.)

3.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë Elbasan të analizojnë mundësinë e ndryshimeve strukturore të strukturës ekzistuese IT me qëllim rritjen e rolit të saj dhe përfshirjen në procesin e menaxhimit të identifikimit të nevojave për investimet në fushën e teknologjisë së informacionit



Brenda Vitit 2019 dhe në vijimësi

4. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi u konstatua se Bashkia Elbasan nuk ka Strategji për Teknologjinë e Informacionit, mungesa e të cilës sjell mos pasqyrimin e objektivave lidhur me infrastrukturën, burimet dhe instrumentet e nevojshëm për matjen e objektivave. Mungesa e Planit Strategjik, mbart riskun e keq adresimit të burimeve të nevojshme për mbështetjen e veprimtarisë së Bashkisë Elbasan

(Më hollësisht trajtuar në pikën VI.4, faqet nr. 24-25. të raportit të Auditimit.)

4.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë Elbasan, duke marrë në konsideratë kohën, burimet e nevojshme si dhe rëndësinë e të dhënave që institucioni posedon dhe përpunon, të marrin masa për hartimin e Planit Strategjik të Teknologjisë së Informacionit, ku të adresohen qartë objektivat e institucionit.

Brenda Vitit 2019 dhe në vijimësi

5. Gjetje nga Auditimi: Standardet e Praktikave me të mira rekomandojnë që Qeverisja TIK duhet të vendosi politika në fushën e IT. Këto politika vendosin kërkesat për mbrojtjen e aseteve të informacionit dhe mund t'i referohen procedurave ose mjeteve të tjera në mënyrën sesi këto do të mbrohen. Politikave duhet të jenë të disponueshme ndaj të gjithë punonjësve përdorues të IT. Bashkia Elbasan nuk ka vendosur politika e parime mbi sigurinë dhe vazhdueshmërinë e punës së institucionit. Bashkia Elbasan nuk ka krijuar facilitetet e nevojshme për vënien në dispozicion të rregulloreve dhe politikave për të gjithë punonjësit përgjegjës mbi sigurinë e informacionit, përfshirë përdoruesit e sistemeve të cilët kanë rol në mbrojtjen e informacionit me qëllim që të gjithë punonjësit të familjarizohen dhe ta bëjnë pjesë të mënyrës së të menduarit dhe të veprimtarisë së tyre të përditshme.

(Më hollësisht trajtuar në pikën VI.4, faqet nr. 25-26 të raportit të Auditimit.)

5.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë Elbasan, të marrin masa për familjarizimin me rregulloret dhe politikave TIK për të gjithë punonjësit përgjegjës mbi sigurinë e informacionit, përfshirë përdoruesit e sistemeve të cilët kanë rol në mbrojtjen e informacionit.

Brenda Vitit 2019 dhe në vijimësi

6. Gjetje nga Auditimi: Rregullorja e Brendshme, lidhur me strukturën IT në Bashkinë Elbasan, nuk është në përputhje me rekomandimet e AKSHIT, rregullorja nuk përmban elementët e nevojshëm për të siguruar funksionimin e përshtatshëm të strukturës IT në institucion.

(Më hollësisht trajtuar në pikën VI.4, faqet nr. 25-26 të raportit të Auditimit.)

6.1 Rekomandimi: Bashkia Elbasan të hartojë, dhe miratojë Rregulloren e Brendshme, lidhur me strukturën IT në përputhje me rekomandimet e AKSHIT. Për hartimin e kësaj Rregulloreje të marret në konsideratë vendosja e kontrolleve të brendshme lidhur me



menaxhimin e riskut, përputhshmërinë me procedurat dhe rregullat e brendshme aktuale të sektorit si dhe me legjislacionin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Shqipëri.

Brenda vitit 2019 dhe në vijimësi

7. Gjetje nga Auditimi: Bashkia Elbasan nuk disponon regjistër risku për teknologjinë e informacionit në mospërputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

7.1. Gjetje nga Auditimi Bashkia Elbasan nuk ka politika të ruajtjes së dokumenteve dhe nuk ka të dokumentuar një plan masash për identifikimin, trajtimin e gabimeve dhe incidenteve që mund të ndodhin në infrastrukturën IT, në mungesë të procedurave të shkruara, risqet menaxhohet mbi bazë ngjarjesh.

Jepet suport, mbështetje teknike dhe logjike për operacionet IT që ndihmojnë mbarëvajtjen e strukturave të institucionit. Procedurat kryhen nëpërmjet shkëmbimeve verbale dhe nëpërmjet e-mail-eve, duke mos realizuar identifikimin e risqeve, mbart riskun e përsëritjes së incidenteve. Identifikimi i risqeve çon në gjetjen e zgjidhjeve për t'i trajtuar ato dhe për të parandaluar ndodhjen e incidenteve të ngjashme në të ardhmen në mënyrë që funksionet e institucionit të jenë të mbrojtura. *(Më hollësisht trajtuar në pikën VI.3., faqet nr. 18-19 të raportit të Auditimit.)*

7.2. Rekomandimi: Strukturat Drejtuese në Bashkinë Elbasan në bashkëpunim me Sektorin e Inovacionit IT dhe mbrojtjes Kibernetike të marrin masa për:

- g. identifikimin e risqeve IT dhe hartimin e regjistrit të risqeve.
- h. dokumentimin dhe monitorimin e incidenteve.
- i. menaxhimin e ndryshimeve dhe dokumentimin e tyre.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2019 dhe në vijimësi

8. Gjetje nga Auditimi: Bashkia Elbasan nuk rezulton të ketë plan të miratuar emergjence dhe politika të miratuara për vazhdimësinë e biznesit. Politika organizative mbi vazhdimësinë e ofrimit të shërbimeve duke marrë në konsideratë: rolet dhe përgjegjësitë, fushëveprimin, kërkesat për trajnim, orarin e mirëmbajtjes, orarin e testimit, nivelet e miratimit dhe palët e përfshira në këtë proces. Nuk janë përcaktuar Objektivat e Kohës së Rimëkëmbjes dhe Objektivat e Punës së Ripërtëritjes për çdo proces kritik.

(Më hollësisht trajtuar në pikën VI.3., faqet nr. 19-20. të raportit të Auditimit.)

8.1. Rekomandimi: Strukturat Drejtuese në Bashkinë Elbasan në bashkëpunim me Sektorin e Inovacionit IT dhe mbrojtjes Kibernetike të marrin masa për miratimin e një plani për emergjence dhe politika mbi vazhdimësinë e biznesit.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2019 dhe në vijimësi



9.a Gjetje nga Auditimi: Siguria e infrastrukturës *network* në Bashkinë Elbasan është e kompromentuar si rezultat i mungesës së:

- a. Active Directory dhe Domain Controller për menaxhimin e userave, pajisjeve dhe aplikacioneve dhe për një identifikim të qendëruar të sigurt të kontrollit dhe menaxhimin e shërbimeve në përputhje me standardet.
- b. server të dedikuar për CA (Certificate Authority)
- c. Server i dedikuar për mail server (Exchange server)
- d. Firewall Hardware
- e. Switch të menaxhueshëm

9.b. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i rrjetit kompjuterik që lidh Bashkinë Elbasan me njësitë administrative rezultoi se:

- a. Përdoruesit në këto qendra janë lidhur nga fibra optike dhe marrin shërbimin në një Swich të pa menaxhueshëm.
 - b. Konfigurimet në rrjet të PC janë si administratorë.
- Në të njëjtin swich marrin shërbime disa institucione

9.c. Gjetje nga Auditimi: Nuk dokumentohet procesi i hapjes dhe mbylljes së logarive të përdoruesve në sisteme.

(Më hollësisht trajtuar në pikën VI.3., faqen nr. 20 të raportit të Auditimit.)

9.1. Rekomandimi: Bashkia Elbasan për mbarëvajtjen e punës dhe për të pasur siguri në rrjet duhet të marrë masat për t'u pajisur me: Active Directory dhe Domain Controller për menaxhimin e userave, pajisjeve dhe aplikacioneve dhe për një identifikim të qendëruar të sigurt të kontrollit dhe menaxhimin e shërbimeve në përputhje me standardet; server të dedikuar për CA; Server i dedikuar për mail server, Firewall Hardware, Switch të menaxhueshëm.

Brenda vitit 2020 dhe në vijimësi

10. Gjetje nga Auditimi: Ambienti fizik i dhomës së rrjetit nuk është në përputhje me standardet e përcaktuara në Rregulloren për Ndërtimin e Dhomës së Serverëve (Versioni 1.0, datë 02.12.2008) miratuar nga AKSHI (Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit) përkatësisht:

- a. Pika 4.3. Parandalimi i zjarrit.

Dhoma duhet të jetë e pajisur me një sistem të përshtatshëm kundër zjarrit

Dhoma duhet të jetë rezistente ndaj zjarrit nëse kabllo dhe sistemet e ftohjes kombinohen në të njëjtën hapësirë sipër tavanit ose nën dysheme

- b. Pika 4.5. Sistemi Elektrik. Instalimi elektrik i dhomës së serverëve nuk është veçmas instalimit të përgjithshëm.



Pika 4.6. Sistemi i Alarmit. Mungon sistemi i alarmit. Duhet të jenë të tillë që të sinjalizojnë problemet me rrymën elektrike, me ambientin fizik, sensor për rrjedhjen e ujit, sensor për parandalimin e dëmtimeve fizike të strukturës së dhomës.

10.a Gjetje nga Auditimi: Mungon Siguria e Hyrjes në dhomë. Duhet të jetë e siguar me anë të një sistemi elektronik dhe natyrisht duhet të ketë dhe sistem alarmi në rast thyerje.

(Më hollësisht trajtuar në pikën VI.4., faqet nr.27-28. të raportit të Auditimit.)

10.1 Rekomandimi: Bashkia Elbasan të marrë masa për ndërtimin e ambienteve të dhomave të serverëve në bazë të VKM nr. 248, datë 27.04.2007 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit” dhe Rregulloren për ndërtimin e dhomës së serverëve (versioni 1.0, datë 02.12.2008) miratuar nga AKSHI, që parashikon përcaktimin e standardeve të TIK dhe praktikat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare.

Brenda vitit 2019 Në vijimësi

11. Gjetje nga Auditimi: Komunikimi ndërmjet Web Browser-it dhe serverit kryhet duke përdorur protokollin HTTP, i cili i merr dhe jep informacion në mënyrë jo të sigurt në rrjet. Kjo sjell që, një sulmues i jashtëm, i cili arrin të hyj në rrjet, ka mundësi të lexojë dhe ndryshojë informacionin i cili aksesohet nga rrjeti, duke përfshirë (fjalëkalimet-et, të dhëna sekret si dhe të tjera të dhëna sensitive).

Mbrojtësi X-XSS i HTTP mundëson shfletuesin (browserin) të mos hapë faqe webi të cilat kapin sulme Cross-Site Scripting (XSS) të reflektuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën VI.4., faqet nr. 28-29. të raportit të Auditimit.)

11.1 Rekomandimi: Drejtorinë e Politikave Strategjike e Inovacionit dhe Medias të marrin masat për të rikonfiguruar Web Server të përdor protokollin HTTPS, i cili kodon komunikimin ndërmjet Web Browserit dhe Serverit.

Gjate vitit 2019 në vijimësi

12. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i Kontratës nr.2474 “Shërbim Interneti për Bashkinë Elbasan dhe Njësitë e vartësisë” rezultoi se grupi i marrjes në dorëzim nuk ka një raport për marrjen në dorëzim të punimeve të kryera (në këtë rast shërbimin e Internetit) nga OE, në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, Neni 77, Pika 3. *Mbikëqyrja e kontratës.*

Në disa nga faturat Tatimore, të sjella nga Operatori Ekonomik Albtelecom SH.A., blerësi në këtë rast Autoriteti Kontraktor (Bashkia Elbasan), ka firmosur këto fatura vetëm me emrin “Bashkia Elbasan” dhe jo “grupi i marrjes në dorëzim të shërbimit të internetit”.

Përkatësisht në faturat nr. 90726620, nr. 90735561.

Ndërsa faturat e tjera janë firmosur vetëm nga një përfaqësues i grupit të marrjes në dorëzim.

4 MNSH

U kontrolluan këto Kontrata për MNSH (Marrëveshje Nivel Shërbimi):

- Nr. Kontrate 8796 “Elbasan Virtual Tour 360”



- Nr. Kontrate 9756 “Projekti i monitorimit të ambientit në qytetin e Elbasanit”
- Nr. Kontrate 472 “Mirëmbajtje e platformës: Transport Inteligent”

12.1 Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i këtyre procedurave rezultoi se në të gjitha marrëveshjet e nivel shërbimit (MNSH), që janë me afat 4 vjeçar, grupi i marrjes në dorëzim nuk ka një raport të marrjes në dorëzim të punimeve të kryera nga OE, në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, Neni 77, Pika 3. *Mbikëqyrja e kontratës*

Për t’u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës dhe në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara zbaton penaltitetet e parashikuara në kontratë. “Autoriteti kontraktor, gjatë kryerjes së kontrolleve mban procesverbal me shkrim në prani të kontraktorit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi” Procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i komisionit që merr në dorëzim.

12.2. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i Kontratës Nr. 8796 “Elbasan Virtual Tour 360” rezultoi se, kjo kontratë nuk ka MNSH (Marrëveshje Nivel Shërbimi) në kundërshtim me pikën 3 të Udhëzimit Nr. 1159, datë 17.3.2014 për Hartimin E Marrëveshjes Së Nivelit Të Shërbimit i cili citon: *“Institucionet, të cilat janë duke zhvilluar sisteme të reja në fushën e TIK-ut, detyrimisht, të parashikojnë MNSH-në, si pjesë të procedurës së realizimit të investimit për këto sisteme. Kohëzgjatja e kësaj marrëveshjeje duhet të jetë jo më e shkurtër se 4 (katër) vjet.”*

c)U konstatua se në të gjitha MNSH nuk përfshihen: *koha e raportimit; koha e përgjigjes; prioriteti; përshkallëzimi*

Kjo në kundërshtim me pikën 7 të Udhëzimit Nr. 1159, datë 17.3.2014 për Hartimin E Marrëveshjes së Nivelit të Shërbimit e cila citon:

Të drejtat dhe detyrimet e ofruesit të shërbimit Ky seksion duhet të përcaktojë të drejtat dhe detyrimet që ofruesi i shërbimit ka ndaj institucionit, në lidhje me ofrimin e shërbimit. Për sa u përket detyrimeve, duhet të përcaktohen metodologjitë dhe specifikat e suportit të ofruesit të shërbimit të MNSH-së; për sa i përket ndërmarrjes së të gjitha veprimeve në kohën e duhur. Në lidhje me shërbimet që do të përcaktohen në marrëveshje, ofruesi i shërbimeve duhet t’u përgjigjet dhe të zgjidhë kërkesat ose incidentet e paraqitura nga institucioni. Gjithashtu, ofruesi i shërbimit duhet të ofrojë dokumentacionin e plotë për komponentët e shërbimit; të garantojë personel të kualifikuar dhe në numër të mjaftueshëm për realizimin e shërbimit; të ofrojë sigurimin e pjesëve të këmbimit (kur është e aplikueshme) dhe në sasinë që do të duhen për t’u ndërruar brenda harqeve kohore të përcaktuara.

Më hollësisht trajtuar në pikën VI.2, faqet nr. 14-17. të raportit të Auditimit.

12.1 Rekomandimi: Strukturat Drejtuese në Bashkinë Elbasan në të ardhmen për të shmangur mangësi në praktikën e zbatimit të kontratave duhet të marrin masa për zbatimin e kontratës në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi



13. Gjetje nga Auditimi: Siguria e aplikacioneve si rezultat i mos dokumentimit të procesit të hapjes dhe mbylljes së kredencialeve të përdoruesve në aplikacionet është e kompromentuar.

Më hollësisht trajtuar në pikën VI.3, faqen nr. 22. të raportit të Auditimit.

13.1 Rekomandimi: Strukturat Drejtuese në Bashkinë Elbasan në bashkëpunim me Sektorin e Inovacionit IT dhe mbrojtjes Kibernetike duhet të marrin masa për dokumentimin e procesit të hapjes dhe mbylljes së kredencialeve të përdoruesve në aplikacione.

Menjëherë dhe në vijimësi

14. Gjetje nga Auditimi: Bashkia Elbasan nuk ka infrastrukturën e nevojshme për të siguruar aplikacionet e zhvilluara, ambienti fizik komprometon sigurinë e aplikacioneve. Bashkia Elbasan nuk ka ambient të veçantë për testime përpara kalimit të ndryshimeve në sistemin Live për aplikacionet mungesa e të cilit komprometon sigurinë e sistemit, të dhënave si dhe vazhdimësinë e ofrimit të shërbimeve.

(Më hollësisht trajtuar në pikën VI.3, faqet nr. 22-23. të raportit të Auditimit.)

14.1 Rekomandimi: Strukturat Drejtuese në Bashkinë Elbasan në bashkëpunim me Sektorin e Inovacionit IT dhe mbrojtjes Kibernetike, të marrin masa për një riorganizim të hapësirave fizike dhe logjike në pajisjet server lidhur me shërbimet që ofron aktualisht, me qëllim:

- Garantimin e vazhdimësisë së shërbimeve të ofruara.
- Përfitim të një performace më të mirë të aplikacioneve.
- Krijim hapësire për një kopje të sistemit në funksion të testimeve apo trajnimeve të ndryshme sipas rastit.

Brenda Vitit 2019 dhe në vijimësi

15. Gjetje nga Auditimi: Sistemi i Administrimit të Taksave (TAIS) nuk ndërvepron me sistemin QKB për të marrë automatikisht të dhënat e bizneseve me impakt mos informimin në kohë për bizneset e reja të regjistruara.

(Më hollësisht trajtuar në pikën VI.3, faqen nr.23 të raportit të Auditimit.)

15.1 Rekomandimi: Strukturat Drejtuese në Bashkinë Elbasan, në bashkëpunim me Sektorin IT dhe Drejtorinë e Taksave Vendore të marrin masa për hartimin e një plan veprimi për të siguruar ndërveprimin e bazës së të dhënave të QKB me atë TAIS.

Brenda Vitit 2019 dhe në vijimësi

16. Gjetje nga Auditimi: Sistemi i Administrimit të Taksave (TAIS) nuk disponon sisteme kontrolli për parandalimin e inputeve të pa sakta në bazën e të dhënave, duke lejuar parregullsi në fushat e rëndësishme të bazës së të dhënave si “NIPT”, “Adresa” “Emërtimi i Biznesit”

(Më hollësisht trajtuar në pikën VI.3, faqen nr.23 të raportit të Auditimit.)

16.1 Rekomandimi: Sektori i Inovacionit IT dhe mbrojtjes Kibernetike në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave Vendore si dhe zhvilluesin e sistemit TAIS, të marrë masa për të



përcaktuar kriteret e nevojshme dhe detyrueshme të formatit për çdo fushë të bazës së të dhënave në TAIS si dhe të vendosi sisteme kontrolli për parandalimin e inpleteve të gabuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

17. Gjetje nga Auditimi: Siguria e vazhdimësisë së punës së aplikacioneve është e cenuar nga:

- a. Mungesa e testeve të Back-up dhe Restore
- b. Mos përcaktimin në rregullore të frekuencës së kryerjes së Back-up dhe testimit të tij
- c. Mos përcaktimi i afatit të ruajtjes së informacionit në Backup
- d. Ruajtjes të Back-up në të njëjtin ambient me bazën e të dhënave primare (dhoma e serverëve).

Më hollësisht trajtuar në pikën VI.3, faqen nr.24 të raportit të Auditimit.

17.1 Rekomandimi: Strukturat Drejtuese në Bashkinë Elbasan në bashkëpunim me Sektorin e Inovacionit IT dhe mbrojtjes Kibernetike, të marrin masa për përcaktimin e kryerjes së testeve të Back-Up dhe Restore, frekuencën e kryerjes së këtyre testeve, afatin e ruajtjes së informacionit në Back-Up si dhe ruajtja e Back Up në një ambient të ndryshëm nga ai i dhomës së serverëve.

Brenda vitit 2020 dhe në vijimësi

DOKUMENTACIONI SHOQËRUES

Pjesë përbërëse e këtij Raporti auditimi është dhe dokumentacioni i mbajtur, si më poshtë:

AKT-KONSTATIME

1. Akt konstatimi nr. 1, datë 15.10.2018
2. Akt konstatimi nr. 2, datë 15.10.2018
3. Akt konstatimi nr. 3, datë 15.10.2018
4. Akt konstatimi nr. 4, datë 15.10.2018
5. Akt konstatimi nr. 5, datë 15.10.2018
6. Akt konstatimi nr. 6, datë 15.10.2018

“Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi”

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Grupi i Auditimit

Kozma KONDAKÇIU, përgjegjës grupi

Meald Habazaj, anëtar

Aldo Kita, anëtar



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËR AUDITIMIN E SISTEMEVE TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT NË
BASHKINË ELBASAN

Tabela e Shkurtimeve

Nr.	Shkurtimi	Emërtimi i Plotë
1	BCP	Business Continuity Plan
2	BCC	Business Continuity Center
3	DR	Disaster Recovery
4	DRC	Disaster Recovery Center
5	KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
6	MNSH	Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit
7	NID	Numri i Identifikimit
8	OE	Operator Ekonomik
9	TI(IT)	Teknologjia e Informacionit
10	TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimi
11	VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
12	SHI	Shoqëria e Informacionit
13	UPS	Uninterruptible Power Supply
14	USB	Universal Serial Bus
15	GG	Government Gateway
16	EDRMS	Electronic Document and Record Management System
17	PKI	Public Key Infrastructure
18	IP	Internet Protocol
19	VPN	Virtual Private Network
20	KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
21	TAIS	Tax Administration Information System
22	FAIS	Financial Administration Information System